



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201500435/2

Tiranë, __. __. 2015

Lënda: *Rekomandohet marrja e masave të menjëhershme për anulimin e faturimit të tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizivë ndaj shtetases S.B..*

Drejtuar: **OPERATORIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE**
Administratorit, Z. Adrian ÇELA,
TIRANË

I nderuar Z. Çela,

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasi **R. B.**, i cili ankohet ndaj "OSHEE" sh.a., Tiranë, lidhur me faturim afrofe të konsumit të energjisë elektrike, për shkak të mungesës së matësit, si dhe faturim të tarifës së televizorit, për kontratën nr. kontrate 573559, në emër të S. B.

Konkretisht, ankuesi pretendon se kontrata e mësipërme, e lidhur në emër të nënës së tij, nuk ka të instaluar matës të energjisë elektrike dhe nga viti 2009, është e pabanueshme, për shkak se znj. S. B., jeton në Tepelenë. Faturimet deri në vitin 2010, janë bërë afrofe, por nga viti 2011, faturimi ka qenë fiks, me vlerë prej 340 lekë. Sipas ankuesit, vazhdimisht kanë kërkuar vendosjen e matësit të energjisë elektrike, por nga "OSHEE" sh.a., nuk është marrë asnjë masë, duke e llogaritur sot këtë faturim si debi.

Gjithashtu ankuesi pretendon se, në faturën tatimore është e përfshirë edhe tarifa e shërbimit për përdorim të aparateve televizivë, në një kohë që nëna, S. B., gëzon statusin e të verbrit, dhe duhet të përjashtohet nga kjo tarifë.

Institucioni i Avokatit të Popullit, duke e konsideruar të drejtë e të bazuar në ligj pretendimin e ankuesit, sa i përket, përjashtimit nga tarifa e shërbimit të aparateve televizivë, ju parashtron sa vijon:

Referuar legjislacionit në fuqi "OSHEE" sh.a., është duke vepruar në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 29, datë 27.12.2011, "Për disa shtesa e ndryshime në udhëzimin Nr. 1 datë 08.01.2009, "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive", të ndryshuar", ku në pikën 2.1 të saj përcaktohet:

"2.1 Nuk janë subjekt i pagimit të tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive, konsumatorët e mëposhtëm familjarë:

a) Invalidët dhe veteranët e luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, invalidët e punës, të verbrit, invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë që e fitojnë këtë status në bazë të ligjit nr.7874, datë 17.11.1994, "Për statusin e veteranit të Luftës kundër Pushtuesit Nazifashist të Popullit Shqiptar", të

ndryshuar; ligjit nr.8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit" dhe ligjit nr.7889, datë 14.12.1994, "Për statusin e invalidit".

Pra, sipas këtij udhëzimi, detyrimi i pagesës së tarifës së televizionit, nga viti 2009, përbën një detyrim abuziv, për një shërbim për të cilën objekti i faturimit është i përjashtuar ligjërisht. Në këto kushte, në mënyrë të menjëhershme, duhet të merren masat për ndërprerjen e faturimit, korrigjimin dhe vendosjen në vend të së drejtës së shkelur, për shtetases S. B.

Ndërsa sa i përket pretendimit, për faturim afrofe për mungesë të matësit të energjisë elektrike, për nevoja të shqyrtimit të mëtejshëm të kësaj ankese, lutemi na dërgoni një informacion të hollësishëm, duke përfshirë se: Cili është shkaku i mosinstalimit të matësit, duke e faturuar afrofe për konsum të energjisë elektrike, nga viti 2009 e në vijim?

Pasi të bëni verifikimet përkatëse, lutemi na përcillni kopje të procesverbalit që do të mbani për çdo konstatim, dhe nëse do të rezultojë që abonentit është faturuar padrejtësisht, anulimin e detyrimeve.

Në përfundim, Institucioni i Avokatit të Popullit, duke e parë vazhdimin e kësaj situatë, si shkak për cenimin e të drejtave dhe interesave të ligjshme të konsumatorit, në bazë të Nenit 63/3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet se: "Avokati i Popullit ka drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga Administrata Publike...", si dhe në bazë të Nenit 21/b të Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku përcaktohet se: "Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive",

REKOMANDOJMË:

- Marrjen e masave të menjëhershme, për anulimin e faturimit të tarifës së televizionit ndaj shtetases S. B.

- Marrjen e masave për vendosjen e matësit të energjisë elektrike.

Në zbatim të nenit 22 të Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, lutemi të informohemi brenda afatit 30 ditor, për qëndrimin që do të mbani ndaj këtij rekomandimi.

K O M I S I O N E R E

Etilda GJONAJ (SALIU)